

# Analiza për Industrinë e Qumështit

Mars 2016



# 1. Hyrje

Zhvillimi i bujqësisë luan rol kyç në zëvendësimin e produkteve të importuara dhe në përmirësimin e bilancit tregtar. Tokat bujqësore në Kosovë janë shumë të fragmentuara (mesatarja për person është 0,15-0,18 hektarë), kurse numri i ekonomive bujqësore është 129,220<sup>1</sup>. Kjo strukturë krijon mundësi për prodhimin e llojeve të ndryshme të kulturave bujqësore, të cilat shërbejnë për hapjen e vendeve të reja të punës, sigurimin e ushqimit dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve në vendet rurale, ku varfëria është më e theksuar.

Qeveria e Kosovës në programin e saj qeverisës 2015-2018, si dhe në Programin Kombëtar të Reformave Ekonomike 2015 ka prioritetizuar zhvillimin e bujqësisë si një ndër mënyrat më reale për përmirësimin e bilancit tregtar dhe rritjen e punësimit<sup>2</sup>. Për këtë qëllim, janë marrë disa masa në përkrahjen e prodhuesve vendor, duke filluar nga dyfishimi i buxhetit për sektorin e bujqësisë, eliminimi i TVSh-së për lëndën e parë bujqësore dhe makineri prodhuese dhe planifikimi për ndërtimin e kapaciteteve ujitëse.

Mirëpo, me gjithë këtë përpjekje, prodhuesit vendor vazhdojnë të përballen me probleme të njëpasnjëshme për t'u qasur në tregun vendor dhe atë të jashtëm. Viteve të fundit, problemet më të theksuara janë vërejtur tek industria e qumështit, ku pjesëmarrja në rritje e produkteve qumështore të importuara, ka rrezikuar mbylljen e shumë fermave vendore.

Shoqatat kosovare të prodhuesve dhe përpunuesve të qumështit kanë organizuar protesta të ndryshme duke kërkuar nga Qeveria që të rris kontrollin e produkteve të importuara të qumështit, ngase ato mund të jenë të dampuara – me çmim më të ulët se në vendin e origjinës – ose të kenë përmbajtje bimore dhe të shiten në treg si produkte shtazore<sup>3</sup>. Sipas këtyre shoqatave, gjithë këto parregullsi ndikojnë që çmimet e produkteve të importuara të jenë më të ulëta se ato vendore dhe kjo rrezikon mbylljen e shumë fermave që në total punësojnë rreth 40 mijë persona.

<sup>1</sup> MBPZHR, Raporti i Gjellbër 2014, qasur më 21.10.2015, <http://bit.ly/1F5RAz6>  
Agjencia e Statistikave të Kosovës, Numri i Ekonomive Bujqësore, qasur më 24.10.2014  
<http://bit.ly/1QIUD6y>

<sup>2</sup> Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, qasur më 07.03.2016,  
<http://bit.ly/1LBjNFP>

Programi Kombëtar për Reforma në Ekonomi 2015, qasur më 07.03.2016,  
<http://bit.ly/1FklShc>

<sup>3</sup> Intervistë me Ramadan Memën, Shoqata e prodhuesve dhe përpunuesve të qumështit, intervistuar më 02.07.2015.

Prandaj, duke marrë parasysh se qumështi është një nga sektorët më strategjik, i cili për shkak të përdorimit ditor mundëson punësimin e një numri të madh të fermerëve, në këtë studim, Instituti GAP ka analizuar problemet konkrete të këtij sektori dhe ka ofruar rekomandime për mundësitë e përmirësimit të gjendjes aktuale.

## 2. Sektori i prodhuesve dhe përpunuesve të qumështit

### 2.1 Prodhimi

Lufta e fundit në Kosovë dëmtoi rëndë sektorin e qumështit duke shkaktuar djegien e mijëra fermave dhe asgjësimin e rreth 50% të bagëtive<sup>4</sup>. Rënia drastike e prodhimit të qumështit ndikoi në ngritjen e papunësisë dhe të deficitit tregtar agro-ushqimor, ndërkaq mundësitë e zhvillimit të këtij sektori përmes investimeve, ishin pothuajse të pamundshme për shkak të qasjes së kufizuar të fermerëve në shërbime kreditore.

Iniciativat e para për ndërtimin e sektorit të qumështit u ndërmorën nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare sikurse USAID dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, të cilat me grante të ndryshme ndihmuan fermerët në ndërtimin dhe renovimin e stallave, pajisjeve të mjeljes, ftohjes (laktofriz) dhe infrastrukturës tjetër përcjellëse<sup>5</sup>. Këto investime patën për qëllim kalimin nga prodhimi vetanak dhe joformal, në prodhim komercial apo të tregut.

Më 4 prill 2007, Qeveria e Kosovës, për herë të parë aprovoi Planin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (PBZhR) 2007-2013, me të cilin krijoi politikat e para mbështetëse për ngritjen e prodhimit komercial të qumështit<sup>6</sup>. Andaj, që nga viti 2010, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) filloi shpërndarjen e pagesave direkte nga 30 euro për krerë lopë, për fermerët që posedonin minimum pesë lopë qumështore. Tabela 1 paraqet trendin e pagesave direkte dhe përfituesve ndër vite.

<sup>4</sup> USAID, Kosovo dairy value chain case study, qasur më 07.03.2016, <http://1.usa.gov/1QIVhRw>

<sup>5</sup> USAID, Kosovo dairy value chain case study, qasur më 07.03.2016, <http://1.usa.gov/1QIVhRw>


<sup>6</sup> MBPZhR, Plani për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, qasur më 07.03.2016, <http://bit.ly/1F5TSy8>

**Tabela: 1:** Pagesat direkte ndër vite

Viti		2010	2011	2012	2013	2014
Lopë qumështore	Numri i përfituesve	4,287	4,162	5,231	5,075	5,472
	Pagesa për krerë	30 €	30 €	50 €	50 €	50 €
	Shuma totale e paguar	1,108,380 €	992,340 €	2,104,800 €	2,105,950 €	2,211,750 €

Burimi: MBPZhR

Këto investime kishin për qëllim ngritjen e numrit të lopëve dhe rrjedhimisht prodhimitarinë vendore. Mirëpo, në Figurën 1 shohim se në vitin 2013 numri i lopëve qumështore dhe sasia e prodhuar arrijnë shkallën më të ulët që nga viti 2007. Kjo rënie është shqetësuese për faktin se konsumi vendor i produkteve të qumështit ka shënuar rritje, mirëpo kjo rritje është mbuluar nga produktet e importuara.

**Figura 1:** Prodhimi i qumështit ndër vite


Burimi: Instituti GAP, bazuar në të dhënat e MBPZhR

Përveç pagesave direkte për lopë qumështore, në vitin 2014, MBPZhR krijoi edhe stimuj financiare për fermerët që prodhonin qumësht cilësor. Pra, qumështi i cilësisë ekstra përfiton 0.06 euro/litër, pasuar me qumështin e klasës së parë (0.04 euro/litër), klasës së dytë (0.02 euro/litër) ndërkaq qumështi i klasës së tretë nuk përfiton asgjë<sup>7</sup>.

<sup>7</sup> MBPZhR, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB), qasur më 19.09.2015, <http://bit.ly/1iBeW5K>

Kjo strukturë mbështetëse ka për qëllim motivimin e fermerëve të përmirësojnë cilësinë e qumështit që dërgojnë tek përpunuesit. Mirëpo, edhe në këto politika vërejmë se në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2014, në vitin 2015 numri i përfituesve të klasës ekstra dhe klasës së parë është për 6% më i vogël. Në Figurën 2 shihet një rënie nga 116,563 euro në tremujorin e parë në 109,640 euro këtë vit.

**Figura 2:** Pagesat qumështore sipas cilësisë



Burimi: MBPZhR

Nga vlerësimi i dy rasteve të subvencioneve, vërejmë se politikat bujqësore nuk kanë treguar rezultat pozitiv as në ngritjen e sasisë dhe as të cilësisë së qumështit. Si pasojë, edhe këtë vit struktura e fermave vazhdon të mbetet skajshmërisht heterogjene me 94.2% të fermave familjare me 1-5 krerë lopë, ndërsa vetëm 5.8% ferma komerciale me mbi 5 krerë lopë<sup>8</sup>. Kjo strukturë krijon kushte të vështira për arritjen e ekonomisë së shkallës dhe rrjedhimisht përmirësimin e konkurrencës në tregun kosovar dhe atë të jashtëm.

## 2.2 Përpunimi

Krahas prodhimit, sipas Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës (AUV), në Kosovë ekzistojnë edhe 43 kompani përpunuese të cilat mbledhin qumështin nga fermerët dhe e përpunojnë atë në produkte me vlerë të shtuar si djathi, kosi, jogurti, ajrani, qumështi i sterilizuar, etj.<sup>9</sup>.

<sup>8</sup> MBPZhR. Analiza e Tregut të Qumështit, qasur më 07.03.2016, <http://bit.ly/1p1Y0ld>

<sup>9</sup> Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës (AUV), Lista e objekteve të aprovuara për përpunim dhe paketim të qumështit, qasur më 20.09.2015, <http://bit.ly/1OBMZ9J>

Disa përpunues furnizohen direkt nga fermerët të cilët prodhojnë sasi të madhe të qumështit, kurse disa tjerë e mbledhin tek qendrat grumbulluese të qumështit ku fermerët me kapacitete të vogla dërgojnë qumështin në një pikë grumbulluese.


Si prodhuesit, ashtu edhe përpunuesit e qumështit janë përfitues të shumë donacioneve ndërkombëtare të cilat ndihmuan në ndërtimin dhe modernizimin e fabrikave të përpunimit të qumështit. Mirëpo, zhvillimi i mëtutjeshëm i tyre është i kufizuar për shkak të tregut që sipas përpunuesve nuk ka rregullim ligjor për disa kategori të produkteve.

Për këtë arsye, më 2015 shoqatat e prodhuesve dhe përpunuesve të qumështit organizuan disa protesta ku kërkuan ndalimin e importit të produkteve që kanë përmbajtje bimore dhe iniciuan hapjen e një hetimi për disa produkte që mund të jenë të dampuara ose të subvencionuara për eksport<sup>10</sup>.

### 3. Importi vs. prodhimi vendor

Gjatë një periudhe pesë vjeçare (2010-2014), Kosova ka importuar rreth 194 milionë litra prodhime të qumështit me një vlerë prej afro 174 milionë euro. Në Figurën 3 shohim se gjatë viteve 2010-2014, importi është rritur vazhdimisht, ndërkaq vetëm në periudhën 2013-2014 trendi i rritjes është përsheptuar dha ka arritur vlerën e 8% të importit.

**Figura 3:** Bilanci tregtar i vlerës së produkteve të qumështit në Kosovë



Burimi: Dogana e Kosovës, përpunuar nga Instituti GAP

<sup>10</sup> Intervistë me Zef Dedaj, MTI, intervistuar më 18.09.2015.



Në vitin 2014, vlera e importit të produkteve të qumështit arrin në afro 37 milionë euro, ndërsa e eksportit në 200 mijë euro. Kjo disbalancë në mes të importit dhe eksportit ka thelluar deficitin tregtar për më shumë se 36 milionë euro, që njëkohësisht është pika më e lartë e regjistruar që nga viti 2010. Importi i produkteve të qumështit në Kosovë vjen nga: Sllovenia (37%), Hungaria (17%), Bosnja dhe Hercegovina (12%), Gjermania (11%), Serbia (9%), Maqedonia (8%), dhe shtete të tjera (5%)<sup>11</sup>.

Sipas të dhënave nga Doganat e Kosovës, importet e prodhimeve të qumështit nga Serbia kaluan prej 327 mijë kilogram në vitin 2013 në 3.8 milionë kilogram në vitin 2014. Shprehur në vlerë monetare, ky import i prodhimeve të qumështit nga Serbia i kushtoi Kosovës 2.75 milionë euro në vitin 2014<sup>12</sup>.

Kjo ngritje e importit vjen përkundër faktit që Kosova ka një potencial shumë të madh si në anën e prodhimit ashtu edhe të përpunimit të qumështit për ta mbuluar kërkesën vendore. Vetëm në vitin 2013, fermerët kosovarë prodhuan afro 369 milionë litra qumësht. Mirëpo, nga prodhimi total, vetëm rreth 49% u plasua në tregun formal nga përpunuesit e qumështit, ndërsa pjesa tjetër u përdor si ushqim për kafshë, konsum vetanak, apo u shit nga fermerët në tregjet joformale<sup>13</sup>. Gjithë ky prodhim mbuloi konsumin vendor në masë prej rreth 84%, ndërsa pjesa tjetër u importua.

Në intervista me disa nga përpunuesit kryesor të qumështit, shohim se ky sektor nuk shfrytëzon as 50% të kapacitetit instalues për arsye se nuk ka kërkesa të mjaftueshme në treg për produkte vendore. Tabela 2 paraqet raportin në mes të prodhimit dhe kapacitetit të katër kompanive të përpunimit të qumështit<sup>14</sup>.

**Tabela 2:** Prodhimi i qumështit, kapacitetet për prodhim dhe shfrytëzimi i këtij kapaciteti në pesë përpunuesit më të mëdhenj vendor

Kompania	Nr. i Punëtoreve	Prodhimi Ditor/litra	Kapacitetet në Ditë/litra	Shfrytëzimi i kapacitetit	Llojet e Prodhimeve
Bylmeti	53	15,000	37,500	40%	6
Sharri <sup>15</sup>	28	13,500	/	/	7
Kabi	32	12,500	25,000	50%	5
Vita	186	25,000	50,000	50%	15

Burimi: Instituti GAP

<sup>11</sup> Dogana e Kosovës, të dhënat për vitin 2014

<sup>12</sup> Dogana e Kosovës, të dhënat për vitin 2014

<sup>13</sup> MBPZHR, Raporti i Gjellbër 2014, qasur më 07.03.2016, <http://bit.ly/1F5RAz6>

<sup>14</sup> Intervistë me pronarët e kompanive të përpunimit të qumështit (Bylmeti, Sharri, Kabi, Vita), intervistuar më 21.07. 2015 dhe 22.07.2015.

<sup>15</sup> Kompani e përpunimit të qumështit Sharri-Prizren

Nga kjo tabelë shohim se sa i përket përpunimit, Kosova mund të dyfishojë prodhimin nëse kërkesa në treg për produktet vendore rritet. Po ashtu, me ngritjen e shfrytëzimit të kapacitetit, shumëfishohet edhe punësimi, përmirësohet ekonomia e shkallës dhe ofrohen mundësi më të mira për eksport në tregjet ndërkombëtare.

Por, aktualisht këto mundësi nuk janë duke u shfrytëzuar ngase sipas shoqatave të prodhuesve dhe përpunueseve të qumështit, çmimi vendor nuk është konkurrues me çmimin e produkteve të importuara të cilat hyjnë në treg në mënyrë joligjore si të dampuara, subvencionuara apo me përmbajtje bimore dhe të shiten si produkte shtazore.

Në një anketë të bërë nga IQ Consulting del se arsyeja kryesore pse konsumatorët kosovarë konsumojnë produkte të importuara është çmimi më i lirë në treg<sup>16</sup>. Andaj, në vijim kemi analizuar vështirësitë kryesore që pengojnë prodhuesit dhe përpunuesit vendor të jenë më konkurrent në tregun kosovar dhe atë të jashtëm.

## 4. Vështirësitë e prodhuesve dhe përpunuesve të qumështit

Që nga viti 2010, MBPZhR ndan miliona euro në zhvillimin e sektorit të qumështit ndërsa gjendja e këtij sektori çdo vit u përkeqësua. Të dhënat zyrtare të MBPZHR tregojnë se prodhimi vendor shënon pikën më të ulët që nga viti 2007, ndërsa importet e produkteve të qumështit rriten vazhdimisht<sup>17</sup>.

Përmirësimi i aftësisë konkurruese të prodhuesve vendor kërkon funksionimin e mirëfilltë të disa hallkave të vlerës, që përbëhet nga prodhuesit, përpunuesit, shitësit e deri te konsumatorët e fundit. Deri tani, mbështetja për sektorin e qumështit është kufizuar vetëm në prodhim dhe përpunim, ndërsa është anashkaluar kontrolli i tregut.

Në këtë analizë shohim se problemet në sektorin e qumështit burojnë nga mos-koordinimi i politikave në mes të ministrive, si MTI dhe MBPZhR. Si rezultat, prodhuesit dhe përpunuesit e qumështit nuk janë konkurrent karshi disa importuesve për shkak të tregut të pakontrolluar, politikave bujqësore joadekuate, eficiencës së ulët, qasjes së limituar në financa, dhe diversifikimit dhe marketingut të pamjaftueshëm.

<sup>16</sup> IQ Consulting, Import Substitution Study for the Dairy Market in Kosovo,

<sup>17</sup> Të dhënat zyrtare të MBPZhR dhe Doganës së Kosovës të paraqitura në Figuren 1, 2, 3.



## 4.1. Mungesa e kontrollit të produkteve të importuara

Një nga arsyet kryesore që disa produkte të importuara të qumështit gjenden në treg me çmime më të ulëta se prodhimet vendore është mungesa e mirëfilltë e kontrollit të importit.

Si rezultat, disa prodhues jashtë vendit shfrytëzojnë këtë situatë dhe hyjnë në treg me produkte të dampuara (çmim nën kosto të prodhimit) ose të subvencionuara, që dëmtojnë prodhimin vendor dhe janë në kundërshtim me praktikën e konkurrencës së lirë të tregut.

Prodhuesit dhe përpunuesit e qumështit duke parë që Autoriteti Kosovar i Konkurrencës pothuajse nuk ekziston, këtë vit ngrehën dyshim tek MTI për disa produkte që mund të jenë të dampuara. MTI në kuadër të Ligjit për masat antidamping dhe kundërbalancuese inicioi një hetim preliminar ku zbuloi se në tregun tonë gjenden disa kompani të cilat kanë tregtuar produkte të qumështit pa marzhë të fitimit<sup>18</sup>.

Arsyetimi i kompanive të dyshuara ishte se shitjet u bënë me akcion gjatë sezonit të verës dhe se nuk ishin të dampuara<sup>19</sup>. Mirëpo, MTI dyshon se këto kompani kanë kaluar kohën e lejuar për mbajtjen e produkteve në akcion si dhe nuk kanë vendosur shenjën “Aktion” siç detyrohen me Ligjin për mbrojtjen e konsumatorit<sup>20</sup>. Tejkalimi i kohës së limituar për shitje të këtilla në një formë konsiderohet damping.

Përveç kësaj, në tregun tonë gjenden edhe produkte që emërtohen si produkte të qumështit ndërsa janë pije me përmbajtje bimore, ku si përbërës kanë vajin e palmës dhe vajra tjera bimore. Këto produkte shiten në të njëjtin raft me produktet e qumështit, gjë që konsiderohet manipulim në bazë të nenit 53 të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit<sup>21</sup>. Shkelje të tilla janë identifikuar edhe në vitin 2014, kur janë suspenduar pesë kompani për manipulim të deklaracionit<sup>22</sup>.

<sup>18</sup> Intervistë me Zef Dedaj, intervistuar më 18.09.2015, MTI bazuar në nenin 17 të Ligjit për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese, ka filluar një hetim preliminarë, qasur më 01.10.2015, <http://bit.ly/1GsscPd>

<sup>19</sup> Intervistë me Zef Dedaj, MTI, intervistuar më 18.09.2015.

<sup>20</sup> Ligji nr. 04/L-121 për mbrojtjen e konsumatorit, neni 19, qasur më 21.09.2015, <http://bit.ly/1V5cJ3o>

<sup>21</sup> Ligji nr. 04/L-121 për mbrojtjen e konsumatorit, qasur më 07.03.2016, <http://bit.ly/219tmJ5>

<sup>22</sup> RTK, Emisioni Subvencion, Industria e qumështit në Kosovë, 16.01.2015, qasur më 05.08.2015, <http://bit.ly/1LHwNPa>

Veprimet e këtilla të eksportuesve kanë për qëllim që së pari të hyjnë në treg me çmime nën koston e prodhimit dhe përmes kësaj të dekurajojnë prodhimin vendor. Këto praktika janë në kundërshtim me ligjet e Kosovës për tregti të lirë.

## 4.2. Politikat bujqësore joadekuate

Skema aktuale e subvencioneve të MBPZhR në periudhë afat-shkurtër ngrit të ardhurat e fermerëve, mirëpo në periudhë afat-gjatë pengon zhvillimin e sektorit të qumështit ngase mbështet dhe i mban në treg edhe fermerët të cilët nuk janë produktiv.

Qëllimi i subvencioneve është të ofrojë stimuj për reformimin e sektorit, që në rastin e Kosovës është (i) ndryshimi i strukturës së fermave dhe kalimi nga prodhimi vetanak (joeficient), në prodhim komercial, (ii) ngritja e prodhimit, dhe (iii) përmirësimi i cilësisë. Ndërsa skema aktuale e subvencioneve nuk po tregohet efektive në asnjërin nga këto qëllime.

Pagesa prej 70 eurove për krerë lopë nuk ka inkurajuar fermerët që të investojnë në përmirësimin e racës ose në mënyrën e të ushqyerit të lopës, që ngritin rendimentin e qumështit, ngase vetëm posedimi i pesë e më shumë lopëve garanton subvencionin. Për këtë arsye, sot kemi 60% të lopëve të racës “Meleze” që kanë rendiment të ulët, dhe 35% të racës “Fisnike” me rendiment të lartë. Këto politika nuk ofrojnë mekanizëm motivues për përmirësim racor i cili ngritë eficientë dhe prodhimin vendor.

**Tabela 3:** Struktura racore e lopëve qumështore dhe prodhimi i qumështit në vitin 2013

Racat	Pjesëmarrja %	Nr. i krerëve	Prodhimi i qumështit / ton	Prodhimi i qumështit / litër
<b>Busha</b>	5	9,167	5,134	5,133,520
<b>Melezet</b>	60	114,388	167,756	167,756,100
<b>Fisnike</b>	35	64,169	195,715	195,715,450
<b>Gjithsej</b>	<b>100</b>	<b>187,724</b>	<b>368,605</b>	<b>368,605,070</b>

Burimi: MBPZhR

Po ashtu, siç është paraqitur në Figurën 1 dhe 2, skemat mbështetëse nuk po arrijnë të tregojnë rezultat pozitiv as në ngritjen e prodhimit dhe as të cilësisë së qumështit. Dhënia e subvencioneve në formë të asistencës sociale ngrit të ardhurat e fermerëve në periudhë

afatshkurtër, mirëpo pengon zhvillimin e sektorit në periudhë afatgjatë.

MBPZHR nuk po arrin të identifikojë fermerët të cilët kanë potencial të madh të prodhimit dhe t'i mbështesë ata në zhvillimin dhe modernizimin e veprimtarisë së tyre. Të gjitha shtetet e zhvilluara kanë ndihmuar fermerët që të specializohen në prodhimtarinë e tyre në mënyrë që të jenë më konkurrent me prodhuesit e tjerë.


Ndërsa në anën tjetër, fermerët të cilët nuk arrijnë të zhvillohen në këtë sektor, duhet të gjejnë përparësitë e tyre krahasuese në sektorët tjerë.

### 4.3. Efiçienca e ulët

Prodhimi dhe përpunimi i qumështit vendor karakterizohet me një efiçienca të ulët dhe kjo ndikon që edhe çmimi në treg të jetë më i lartë se prodhimet e vendeve të rajonit.

Ndonëse në vitin 2013, fermerët kanë arritur që dukshëm të përmirësojnë produktivitetin dhe rendimentin e lopëve qumështore, në krahasim me vendet e rajonit, prapë qëndrojmë me një efiçienca të ulët. Figura 4 paraqet prodhimin në litra për lopë qumështore gjatë viteve 2007-2013.

**Figura 4:** Prodhimi vjetor i qumështit në litra për lopë qumështore



Burimi: MBPZHR, përpunuar nga Insituti GAP


Aktualisht, mesatarja e prodhimit për lopë qumështore është 5.7 litra në ditë, ndërsa në Serbi dhe vendet e BE-se është rreth 8.2 litra dhe 17

litra respektivisht<sup>23</sup>. Andaj, përkundër rritjes së produktivitetit, fermerët vendor kanë ende hapësirë të ngritin eficiencën përmes përmirësimit të mënyrës së ushqyerit të lopëve qumështore dhe përmirësimit racor.

Me eficiencë të ulët operojnë edhe përpunuesit e qumështit të cilët nuk shfrytëzojnë as 50% të kapacitetit të tyre ndërkohë që paguajnë njëjtë kostot fikse.

Po ashtu, përpunuesit përballen me kosto të lartë të transportit ngase përveç përpunuesit vendor Vita, të tjerët nuk kanë të instaluar teknologjinë e paketimit me temperaturë ultra të lartë (UHT), i cili mundëson ruajtjen e qumështit për një përudhë të gjatë kohore<sup>24</sup>. Si rezultat, përpunuesit vendor detyrohen që në baza ditore të transportojnë qumështin në treg. Kjo pasqyrohet edhe te diferenca në mes të çmimit të fermerëve, që është konkurent me atë të rajonit, dhe përpunuesve që është mjaft i lartë dhe me trend të rritjes.

**Figura 5:** Çmimet e qumështit sipas viteve



Burimi: MBPZhR

<sup>23</sup> Perspectives of the Serbian dairy sector in the process of integration into global markets, qasur më 18.09.2015, <http://bit.ly/1FWNPaz>

<sup>24</sup> Intervistë me pronarët e kompanive të përpunimit të qumështit (Bylmeti, Sharri, Kabi, Vita), intervistuar më 21, 22.07.2015.

## 5. Qasja e kufizuar në financa

Në krahasim me sektorët tjerë, bujqësia është sektori i cili përballet me problemet më të madha në qasje në kredi. Pjesëmarrja totale e sektorit të bujqësisë në kredi është më e vogël se 3.6%, që paraqet pengesë në zhvillimin e këtij sektori<sup>25</sup>.

Për të ngritur kreditimin në bujqësi, më 26 shtator 2012, MBPZhR në bashkëpunim me USAID dhe gjashtë banka komerciale në Kosovë<sup>26</sup> themeluan Autoritetin për Zhvillim Kreditor (AZhK) i cili ka një fond që garanton bankave komerciale 50% të kredisë.

Ky projekt është paraparë të zgjasë deri në vitin 2020, dhe ka për qëllim uljen e normave të interesit deri në 10%. Tri vite pas themelimit të këtij fondi, normat e interesit për bujqësi kanë rënë për vetëm 3-5% ndërsa kreditë joperformuese ishin vetëm pesë nga 193 kredi të lëshuara<sup>27</sup>.

Së fundmi, MTI ka hartuar projektligjin për themelimin e një fondit tjetër për garanci të kredive, i cili ka për qëllim ngritjen e qasjes së fermerëve në kredi. Mirëpo, në diskutim me prodhuesit dhe përpunuesit e qumështit, thuhet se ky sektor ende vazhdon të përballet me vështirësi të shumta si në kualifikim për kredi ashtu edhe në norma të larta të interesit dhe kjo pengon zhvillimin e agrobizneseve.

## 6. Diversifikimi dhe marketingu i pamjaftueshëm

Një pengesë tjetër e sektorit është që përpunuesit vendor nuk janë proaktiv ndaj kërkesave të tregut. Në shumicën e rasteve ata ofrojnë vetëm një numër të kufizuar të produkteve dhe nuk janë kreativ me ofrimin dhe diversifikimin e produkteve të reja. Për shembull, përpunuesit kosovarë ende nuk prodhojnë produktet si: jogurti i frutave, kaçkavalli i cilësisë së lartë, djathërat me mëlmesa të ndryshme, të cilat konsumohen në Kosovë mirëpo për shkak të mungesës së kuadrit profesional ato nuk prodhohen në Kosovë por importohen.

Po ashtu, përpunuesit e produkteve të qumështit nuk kanë investuar mjaft në marketing, qoftë individualisht, qoftë mbështetur nga qeveria apo organizata tjera. Aktualisht mungon targetimi i qyteteve

<sup>25</sup> BQK, Raporti i stabilitetit financiar 2015, qasur më 07.03.2016, <http://bit.ly/1N9N5RL>

<sup>26</sup> Raiffeisen Bank, TEB, ProCredit Bank, BKT, NLB dhe Banka Ekonomike

<sup>27</sup> Instituti GAP, Fondi Kosovar për garanci kreditore, qasur më 07.03.2016 <http://bit.ly/1j1UJpz>

apo bizneseve që konsumojnë sasi të konsiderueshme të qumështit e që përdorin produkte të importuara. Në këtë sektor marketingu shpeshherë konsiderohet si shpenzim dhe jo si investim.

## 7. Pako e re fiskale jo favorizuese

Ndryshimet në pakon e re fiskale, përkatësisht ndryshmet në Ligjin mbi tatimin në të ardhurat personale, janë cilësuar si jo favorizuese nga shoqata e prodhuesve të qumështit. Ky ligj parasheh që secili fermer që dorëzon qumësht në qumështore ose pika grumbulluese me vlerë totale vjetore nën 30 mijë euro, është i obliguar që të paguajë 3% të fitimit<sup>28</sup>. Zbatimi i këtij ligji është vlerësuar se do të rris hendekun e prodhimit të qumështit ngase dëmton të ardhurat e fermerëve.

Probleme me këtë ligj paraqiten edhe tek zbatimi i tij ngase janë përpunuesit apo pikat grumbulluese ato të cilat janë të obliguara të bëjnë mbledhjen e këtij tatimi nga fermerët kur dorëzohet qumështi dhe pastaj ta paguajnë atë në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) së bashku me tatimet e tjera të përpunuesve.

<sup>29</sup> Ligji nr. 03/L-061 mbi tatimin në të ardhura personale, neni 43, paragrafi 2, nën paragrafi 2.1.1, qasur më 07.03.2016, <http://bit.ly/1Rse8JZ>



## Përfundime dhe rekomandime

Në këtë raport është analizuar gjendja e sektorit të qumështit, problemet dhe potencialet. Sektori i qumështit përballet me probleme të mëdha, ku prodhimi në vitin 2014 arrin pikën më të ulët që nga viti 2007, ndërsa importi pikën më të lartë.

Pengesë për zhvillimin e sektorit të qumështit në periudhë afat-shkurtë është prezenca e produkteve të dampuara dhe të subvencionuara në treg si dhe manipulimi i konsumatorëve. Ndërsa në periudhë afat-gjate, janë politikat mbështetëse të cilat nuk adresojnë problemet strukturore të sektorit të qumështit.

Po ashtu, raporti identifikon edhe disa probleme të tjera si eficientia e ulët e prodhuesve dhe përpunuesve, marketingu i pamjaftueshëm, qasja e vështirë në financa si dhe normat e larta të interesit.

Këto probleme kanë rezultuar edhe nga mos-koordinimi i politikave në mes të institucioneve ekonomike dhe monitorimit të pamjaftueshëm të rezultateve të këtyre politikave.

Prandaj, duke marrë parasysh potencialin e madh të sektorit të qumështit në ngritjen e punësimit si dhe në përmirësimin e bilancit tregtar, Instituti GAP në vijim ofron disa rekomandime që bazohen direkt në problemet kryesore të këtij sektori.

Për MTI:

- Pas hetimit preliminar, të fillojë hetimin zyrtarë të kompanive të cilat dyshohet se janë duke bërë dumping ngase kanë shkelur nenin 19 të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit (Shitja me aksion);
- Komisioni vlerësues t'i rekomandojë Qeverisë së Kosovës të vendos masa të përkohshme (Neni 19) të ndalimit të importit të produkteve të cilat dyshohen se janë të dampuara ose të subvencionuara deri sa të përfundojë hetimi, siç parashihet me Ligjin për masat antidamping dhe kundërbalancuese;
- Të shtojë kujdesin ndaj kompanive të cilat dëmtojnë prodhuesit vendor duke shkelur ligjin për mbrojtjen e konsumatorit nga emërtimi dhe vendosja e produkteve në mënyrë joligjore dhe manipuluese;
- Të nxjerr një udhëzim administrativ ku identifikohen qartë produktet e qumështit me përmbajtje shtazore dhe ato me përmbajtje bimore dhe të kërkohet që të mos shiten në raftin e

njëjtë për arsye se është në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit (neni 53, praktikat mashtruese);

- Të kërkojë nga inspektorët që të kontrollojnë shitjen e produkteve, zbatimin e udhëzimit administrativ ndaj ndarjes fizike të produkteve bimore dhe shtazore, si dhe respektimin e ligjit për mbrojtjen e konsumatorit;
- Të informohet Dogana e Kosovës për tatimin e pijeve të qumështit (bimore) dhe të ndërpritet praktika e hyrjes në doganë të pijeve qumështore si produkte të qumështit ose të vendoset një akcizë për produktet bimore;

Për MBPZhR:

- Të zëvendësojë pagesat direkte për krerë lopë qumështore me pagesa për sasi të qumështit të prodhuar, siç kanë vepruar disa vende të rajonit. Kjo do t'i motivojë fermerët që të përmirësojnë praktikën e të ushqyerit të lopëve, ndryshojnë strukturën racore të lopëve, dhe ngritjen e numrit të lopëve;
- Të rris sasinë e pagesave direkte që i dedikohen cilësisë së qumështit dhe të zvogëlojë pengesat burokratike për përfituesit e këtyre pagesave;
- Në bashkëpunim me komunat, të ndihmojë teknikisht dhe financiarisht shoqatat e prodhuesve dhe përpunuesve të qumështit të organizojnë kampanja informuese dhe promovuese në të gjitha komunat e Kosovës për cilësinë e qumështit vendor;

Për MF:

- Të pezullojë aplikimin e nenit 43, paragrafin 2, nën paragrafin 2.1.1. për 3% që parashihet në Ligjin nr. 03/L-061 mbi tatimin në të ardhurat personale;

Për përpunuesit:

- Të shqyrtojnë mundësitë e financimit për blerjen e teknologjisë paketuese me temperaturë ultra të lartë (UHT), e cila do t'i zvogëlonte shpenzimet operative dhe njëkohësisht çmimin final në treg;
- Të diverzifikojnë produktet e qumështit konform kërkesave të tregut;
- T'i targetojnë me oferta të ndryshme qytetet dhe bizneset të cilat konsumojnë më shumë produkte të importuara;
- Të investojnë në rritjen e efikasitetit apo uljen e çmimit në mënyrë që të bëhen më konkurrues me produktet e importuara.

Instituti GAP është Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

**Instituti GAP mbështetet nga:**



**Ky projekt është mbështetur nga:**

